

DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA  
E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË  
KOSOVËS

**Një përshkrim i  
shkurtër i Dhomave  
të Specializuara të  
Kosovës**



DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E  
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës u krijuan në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës, një amendamenti kushtetues dhe Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.


Ato janë të përkohshme dhe me mandat dhe juridiksion të përcaktuar për krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera të përkufizuara sipas ligjeve të Kosovës, të cilat pretendohen se kanë filluar të kryhen apo janë kryer në Kosovë nga 1 janari i vitit 1998 deri më 31 dhjetor të vitit 2000 nga, apo kundër qytetarëve të Kosovës, apo të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës kanë një seli në Hagë, Holandë. Personeli i tyre që përfshin edhe gjykatësit, Prokurorin e Specializuar dhe Administratoren, është ndërkombëtar.

# Një përshkrim i shkurtër i Dhomave të Specializuara të Kosovës



DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E  
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS



# Përmbajtja

<b>THEMELIMI</b>	<b>7</b>
<b>MANDATI DHE JURIDIKSIONI</b>	<b>11</b>
<b>STRUKTURA</b>	<b>13</b>
<b>TË DREJTAT E TË AKUZUARVE</b>	<b>19</b>
<b>PJESËMARRJA E VIKTIMAVE</b>	<b>23</b>
<b>AVOKATI I POPULLIT</b>	<b>24</b>
<b>ÇËSHTJET GJYQËSORE AKTUALE</b>	<b>25</b>
<b>FJALORTH I SHKURTËR I TERMAVE JURIDIKË</b>	<b>26</b>




# Themelimi

**Dhomat e Specializuara të Kosovës u themeluan mbi bazën e pretendimeve se disa krime të rënda, të kryera gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë (1998-2000), nuk ishin hetuar dhe ndjekur penalisht.**

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës caktoi një Raportues të Posaçëm, senatorin Dik Marti që të hetonte lidhur me këto pretendime. Ai dorëzoi raportin në muajin dhjetor 2010, i cili u miratua nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës më 7 janar 2011, ku u rekomandua që të hetohej në lidhje me këto pretendime brenda mandatit të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX).

Në muajin maj të të njëjtit vit, Bashkimi Evropian formoi Task Forcën Hetimore Speciale (TFHS) në vartësi të EULEX-it për hetimin e pretendimeve të ngritura në raport.

Në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë dhe Presidentja e Kosovës nënshkruan një **marrëveshje ndërkombëtare** për krijimin e dhomave gjyqësore të veçanta e të pavarura, ose ndryshe Dhomat e Specializuara, për gjykimin e krimeve që mund të dilnin në dritë nga hetimet e TFHS-së. Marrëveshja **u ratifikua nga Kuvendi i Kosovës** në muajin prill 2014. Me anë të kësaj marrëveshje, Kosova barti të gjitha mandatet, kompetencat dhe funksionet e nevojshme ekzekutive për funksionimin e Dhomave të Specializuara. U ra dakord se Dhomat e Specializuara do të funksiononin sipas **statutit** të vet, do të miratonin **rregulloren e vet të procedurës dhe provave** dhe do të kishin **selinë në një shtet të tretë**. Në pajtim me marrëveshjen, gjykatësit dhe personeli do të ishin vetëm ndërkombëtarë. Për më tepër, çdo dënim i dhënë do të kryhej jashtë territorit të Kosovës.






Dhomat e Specializuara, unike dhe autonome, do të siguronin që drejtësia të vihej në vend në mënyrë **të pavarur** dhe **të paanshme, pa ndërhyrje politike** dhe duke u angazhuar tërësisht për **sigurinë, jetën** dhe **mirëqenien** e dëshmitarëve dhe viktimave.

Në pajtim me **amendamentin kushtetues** (neni 162) të konfirmuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës dhe të miratuar nga Kuvendi i Kosovës në gusht 2015, Kuvendi **miratoi Ligjin për Dhomat e Specializuara të Kosovës** dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji). Në muajin janar 2016 u nënshkrua Marrëveshja me Shtetin Pritës, me Holandën, që mundësonte që Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ta kenë selinë në Hagë, Holandë.

Në mars 2017, në plenaren e parë, gjykatësit e DHSK-së miratuan Rregulloren e Procedurës dhe të Provave para DHSK-së (Rregullorja). Rregullorja hyri në fuqi në muajin korrik 2017, pas rishikimit kushtetues nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese. Dhomat e Specializuara të Kosovës u bënë funksionale në aspektin gjyqësor, me hyrjen në fuqi të Rregullores së Procedurës dhe të Provave.






# Mandati dhe Juridiksioni

Dhomat e Specializuara të Kosovës u krijuan si një institucion **i përkohshëm** gjyqësor që trajton vetëm përgjegjësinë penale të **personave**. DHS-ja nuk heton apo ndjek penalisht grupe, organizata ose bashkësi etnike. Mandati i saj është “ të garantojë procedura penale të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase në lidhje me pretendimet për krime të rënda ndërkuftare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë konfliktit në Kosovë dhe pas tij, të cilat ndërlidhen me ato që janë raportuar në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës [...] dhe të cilat kanë qenë objekt i hetimeve penale nga [TFHS]”.

## Juridiksioni lëndor



Juridiksioni i DHSK-së mbulon krime kundër njerëzimit dhe krime luftime që janë kryer midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000 që kanë filluar të kryhen apo janë kryer në Kosovë, ose që janë kryer nga persona me shtetësi të Kosovës/Republikës Federale të Jugosllavisë, ose ndaj personave me shtetësi të Kosovës/Republikës Federale të Jugosllavisë. Gjithashtu, DHSK-ja ka juridiksion mbi vepra penale të caktuara kundër administrimit të drejtësisë kur kanë lidhje me procedurat zyrtare dhe/ose me zyrtarë të DHSK-së.

DHSK-ja financohet plotësisht nga Bashkimi Evropian dhe pjesërisht nga pesë shtete kontribuese (Shtetet e Bashkuara, Norvegjia, Zvicra, Kanadaja dhe Turqia). DHSK-ja do të funksionojë deri në kohën kur Këshilli i Bashkimit Evropian do të njoftojë qeverinë e Kosovës për përfundimin e mandatit të saj.

## Zyra e Prokurorit të Specializuar

(hetim, ndjekje penale)

## Dhomat e Specializuara të Kosovës

(procedurat gjyqësore, aktgjykimet)

## Prokurori i Specializuar

## Dhomat

## Zyra Administrative



Prokurori i Specializuar




Kryetare



Administratore

## Përbërja e Dhomave



# Struktura

DHSK-ja dhe ZPS-ja janë dy institucione tërësisht të **ndryshme** dhe të **pavarura**. ZPS-ja është përgjegjëse për kryerjen e hetimeve dhe ndjekjen penale të personave të cilët akuzohen se janë përgjegjës për krime dhe vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.

Dhomat e Specializuara përbëhen nga dy organe, Dhomat dhe Zyra Administrative. Zyra Administrative është përgjegjëse për të gjitha funksionet kryesore mbështetëse të gjyqësorit si paraburgimi, administrimi i gjykatës, ndihma juridike, pjesëmarrja e viktimave dhe përkthimet me gojë dhe me shkrim.

Dhomat përfshijnë Kryetarin, Zëvendëskryetarin dhe gjykatësit në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtar. Gjatë procesit të përzgjedhjes, Ligji përcakton që gjykatësit duhet të jenë individë me karakter të lartë moral, të paanshëm dhe të ndershëm, të cilët plotësojnë kriteret e duhura në vendet e tyre përkatëse për t'u emëruar në postet më të larta gjyqësore. Dhomat e Specializuara janë të organizuara sipas sistemit të gjykatave në Kosovë dhe për këtë arsye përfshijnë Dhomën e Gjykatës Themelore, Dhomën e Gjykatës së Apelit, Dhomën e Gjykatës Supreme dhe Dhomën e Gjykatës Kushtetuese.

## GJYKATA THEMELORE

Dhoma e Gjykatës Themelore e DHSK-së kryen procedurën paraprake dhe gjykon çështje gjyqësore të paraqitura nga Prokurori i Specializuar në shkallën e parë.

Pasi paraqitet një aktakuzë nga Prokurori i Specializuar, Kryetari cakton Gjykatësin e Procedurës Paraprake. Detyra e parë e tij është shqyrtimi i aktakuzës dhe më pas gjykatësi vendos nëse provat e përfshira në aktakuzë janë të mjaftueshme për të konfirmuar aktakuzën (e paraqitur nga Prokurori i Specializuar) pjesërisht ose plotësisht, ose për ta refuzuar atë. Prokurori i Specializuar mund të paraqesë një aktakuzë të ndryshuar për miratim/konfirmim që mbështetet me prova të reja.

Pasi konfirmohet aktakuza, viktimat që kanë vuajtur drejtpërdrejtë nga krimet e përfshira në aktakuzë mund të parashtrojnë kërkesë për pjesëmarrje në procesin gjyqësor.

Një i akuzuar që është arrestuar ose thirrur nga Dhomat e Specializuara paraqitet para Gjykatësit të Procedurës Paraprake në atë që njihet si “ paraqitja e parë”. Në këtë fazë të procesit, i akuzuari ftohet të deklarojë nëse është fajtor ose i pafajshëm për akuzat e ngritura në aktakuzë.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake është përgjegjës për përgatitjen e çështjes para se të kalojë për gjykim në Gjykatën Themelore. Këtu përfshihen një numër vendimesh si organizimi i çështjes, përcaktimi i procesit për nxjerrjen e provave, organizimi i pjesëmarrjes së viktimave, marrja e vendimeve lidhur me masat mbrojtëse, rishikimi i qëndrimit në paraburgim të të akuzuarit dhe vendime lidhur me mocionet paraprake të paraqitura nga Mbrojtja dhe Prokurori i Specializuar.

Pasi merren vendimet që lidhen me aspektin e përgatitjes dhe trajtohen mocionet paraprake, Gjykatësi i Procedurës Paraprake njofton Kryetarin se çështja është gati për gjykim. Më pas Kryetari cakton për gjykim trupin gjykues të Gjykatës Themelore. Si rregull, trupi gjykues përbëhet nga tre gjykatës dhe një gjykatës rezervë.

Gjatë procesit të gjykimit, trupi gjykues dëgjon dëshmitarët dhe shqyrton provat e tjera të paraqitura prej Prokurorit të Specializuar dhe Mbrojtjes. Në parim proceset janë publike përveçse kur nevojitet të kryhen në seancë private ose të mbyllur për arsye të mbrojtjes së dëshmitarëve, viktimave ose informacionit konfidencial. Pasi Prokurori i Specializuar dhe Mbrojtja kanë thirrur dëshmitarët e tyre dhe kanë paraqitur provat, gjykatësit kuvendojnë mes tyre nëse Prokurori i Specializuar ka mundur të vërtetojë akuzat jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Në momentin që gjykatësit arrijnë vendimin atëherë shpallin gjykimin.



Nëse i akuzuari shpallet fajtor për disa ose të gjitha akuzat e ngritura në aktakuzë, atëherë trupi gjykes, në varësi të akuzës, mund të japë dënimin më të lartë me burgim të përjetshëm, dhe mund ta urdhërojë personin e dënuar që ta dëmshpërblejë ose ta kompensojë viktimën apo viktimat bashkërisht. Gjithashtu, trupi gjykes mund të urdhërojë që çdo pronë ose pasuri që është përdorur për kryerjen e krimeve ose që është përfituar përmes kryerjes së krimeve, të sekuestrohet dhe t'i kthehet pronarit të ligjshëm ose fitimet nga shitjet e tyre t'u jepen viktimës/viktimave.

## **DHOMA E GJYKATËS SË APELIT**

Paneli i Gjykatës së Apelit shqyrton apelet e ndërmjetme që paraqiten gjatë procedurës paraprake dhe gjatë gjykimit nga të akuzuarit dhe Prokurori i Specializuar. Paneli i Gjykatës së Apelit mund të shqyrtojë edhe apelet kundër aktgjykimit. Mbrojtësi i viktimave mund të a pelojë a ktgjykimin sa i takon vendimit të trupit gjykues lidhur me pjesëmarrjen e viktimave ose zhdëmtimet.

Paneli i Gjykatës së Apelit mund t'i lërë në fuqi, prapësojë, ose ndryshojë aktgjykimet e trupit gjykues dhe mund të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme. Paneli mund ta kthejë të gjithë çështjen ose pjesë të saj për rigjykim te trupi gjykues që ky i fundit ta trajtojë çështjen në mënyrë më efikase. Paneli i jep gjykimet në seancë publike.

## **DHOMA E GJYKATËS SUPREME**

Paneli i Gjykatës Supreme kryesohet nga Kryetari i DHSK-së dhe mund të shqyrtojë apele kundër aktgjykimit të apelit, por vetëm në rrethana të kufizuara që do të thotë (i) në rastet kur paneli i Gjykatës së Apelit rrëzon vendimin e pafajësisë dhe jep vendim fajësie; ose (ii) kur trupi gjykues ose paneli i Gjykatës së Apelit japin dënim me burgim të përjetshëm.

Paneli i Gjykatës Supreme mund të angazhohet edhe në rastet kur një palë kërkon rihapje të procesit penal.


Së fundi, paneli i Gjykatës Supreme mund të shqyrtojë kërkesa lidhur me mbrojtjen e ligjshmërisë. Një kërkesë e tillë duhet të paraqesë pretendime se ka (i) shkelje të së drejtës penale të përfshirë në Ligj ose (ii) shkelje thelbësore të procedurave të përcaktuara në Ligj dhe në Rregullore. Këto kërkesa mund të bëhen ndërkohë që proceset janë në kryerje e sipër ose pas dhënies së gjykimit të formës së prerë.

Në kohën që proceset gjyqësore janë në kryerje e sipër, një i akuzuar mund të parashtrojë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundrejt vendimeve të formës së prerë ku urdhërohet ose zgjatet mbajtja në paraburgim.

Pas aktgjykimit të formës së prerë, një palë mund të kërkojë mbrojtjen e ligjshmërisë. Kjo kërkesë duhet parashtruar brenda tre muajsh pas dhënies së aktgjykimit ose vendimit të formës së prerë.



## PROCESI GJYQËSOR

**DHOMA E SPECIALIZUAR E GJYKATËS KUSHTETUESE**

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese (DHSGJK) është autoriteti më i lartë për interpretimin e Kushtetutës së Kosovës në lidhje me aspekte të mandatit të DHSK-së dhe ZPS-së.

DHSGJK-ja mund t'i shqyrtojë këto aspekte përmes disa mënyrash. Më konkretisht çdo individ, përfshirë të akuzuarit dhe viktimat mund t'i paraqesin DHSGJK-së referim ku pretendojnë se Dhomat e Specializuara ose Prokurori i Specializuar kanë shkelur të drejtat e tyre themelore të garantuara me Kushtetutën e Kosovës, Sidoqoftë referimi mund të bëhet vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e tjera juridike.

Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose çdo panel tjetër i Dhomave të Specializuara sikurse edhe Avokati i Popullit mund t'i paraqesin DHSGJK-së referime lidhur me pajtueshmërinë kushtetuese.

Si funksionon?



## Të drejtat e të akuzuarve

Korniza ligjore e DHSK-së përcakton të drejtat themelore të të akuzuarve. Këto të drejta jo vetëm mbrojnë të dyshuarit apo të akuzuarit, por mbi të gjitha sigurojnë integritetin e proceseve duke garantuar që drejtësia të vendoset në mënyrë **transparente** dhe të **drejtë** dhe të gjitha palët në proces të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe t'u jepen mundësi të shumta për të paraqitur ose kundërshtuar prova, sipas nevojës. **Supozimi i pafajësisë** është një parim i njohur në gjithë botën që DHSK-ja e respekton plotësisht, i cili dikton se të dyshuarit dhe të akuzuarit konsiderohen të pafajshëm deri në momentin kur fajësia e tyre provohet jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Nuk është detyrimi i tyre të vërtetojnë pafajësinë e vet, por është Prokurori i Specializuar që ka detyrimin të vërtetojë akuzat e përfshira në aktakuzë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Ky është një standard i lartë që përmbushet vetëm nëse provat e paraqitura prej Prokurorit të Specializuar tregojnë qartë se përfundimi i vetëm logjik është që i akuzuari ka kryer krimin ose krimet për të cilat akuzohet.


Prokurori i Specializuar duhet të vendosë në dispozicion të Mbrojtjes provat që synon të përdorë për të vërtetuar akuzat kundër të akuzuarit. Gjithashtu, Prokurori i Specializuar duhet të vendosë në dispozicion provat që ka në zotërim që mund të sugjerojnë pafajësinë e të akuzuarit. Ky proces që njihet si procesi i “nxjerrjes së materialeve” kryhet brenda afateve të përpikta dhe ka si synim që t'i japë mundësi Mbrojtjes të kundërshtojë akuzat ndaj të akuzuarit duke pasur njohuri të plota rreth provave mbi të cilat ka ngritur akuzat ZPS-ja. Pikërisht ky detyrim i ZPS-së siguron dhe drejtësinë e procesit.

Një e drejtë tjetër themelore që u garantohet të akuzuarve është që të përfaqësohen nga mbrojtës që i zgjedhin vetë. Kjo mundëson pjesëmarrje efektive të të akuzuarit gjatë procesit, për shembull me anë të pyetjeve të dëshmitarëve, kundërshtimit të provave kundër të akuzuarit dhe apelimit të vendimit të gjykatësve. Në rastet kur një i akuzuar nuk ka mjete financiare të mjaftueshme për pagesën e mbrojtësit, atëherë DHS-ja do ta paguajë mbrojtësin në përputhje me **sistemin e gjerë të ndihmës juridike**.

Personave të akuzuar u jepet kohë dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tyre. Gjithashtu, ata duhet të informohen sa më shpejt mbi llojin dhe shkakun e akuzave të ngritura ndaj tyre në një gjuhë që e kuptojnë. Faktikisht, të akuzuarit mund të kundërshtojnë akuzat dhe provat kundër tyre, t'u bëjnë pyetje dëshmitarëve dhe të përgatisin mbrojtjen vetëm nëse dinë dhe kuptojnë për çfarë janë akuzuar dhe mbi çfarë baze.

Të akuzuarit kanë të drejtë të ndjekin procesin në një gjuhë që e kuptojnë. Gjuhët zyrtare të DHSK-së janë shqipja, serbishtja dhe anglishtja. Nëse i akuzuari nuk flet asnjë prej këtyre gjuhëve, atëherë mundësohen përkthyes me gojë për të ndihmuar në komunikim.

Një e drejtë tjetër e rëndësishme e të akuzuarit është që të gjykohet brenda një kohe të arsyeshme. Përkufizimi i kohës së arsyeshme në këtë rast varet nga lloji dhe rrethanat e çështjes gjyqësore. Proceset penale janë të vështira për të gjitha palët e përfshira. Marrja e vendimit në kohë nuk u shërben vetëm viktimave dhe dëshmitarëve që duan të gjejnë drejtësi, por edhe të akuzuarve si dhe familjeve të tyre të cilët jetojnë në pasiguri për të ardhmen deri në momentin e shqiptimit të aktgjyqimit.



*Dy pjesët e sallës së gjyqit*

Së fundi, të akuzuarit nuk mund të detyrohen të dëshmojnë kundër vetes ose të pranojnë fajin dhe dëshmi të tilla nuk mund të përdoren kundër tyre. Si rrjedhojë, të akuzuarit nuk mund të bëhen përgjegjës dhe të dënohen nëse nuk pranojnë t'u përgjigjen pyetjeve vetinkriminuese ose nëse vendosin të deklarohen të pafajshëm. Është detyra e Prokurorit të Specializuar të vërtetojë akuzat kundër të akuzuarit jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.

Të drejtat themelore më lart të cilat mishërohen në Ligj dhe Rregullore, nuk janë as të reja dhe as unike për DHSK-në. Këto të drejta pasqyrojnë standardet ndërkombëtare dhe zbatohen për të akuzuarit si në nivel shtetëror ashtu dhe ndërkombëtar.

Respektimi i këtyre të drejtave themelore nuk cenon aspekte të tjera po aq të rëndësishme të procesit, ku përfshihet dhe detyra e rëndësishme e garantimit të sigurisë së dëshmitarëve dhe viktimave që paraqiten para DHSK-së. Dhomat e Specializuara i kushtojnë kujdes të duhur mbrojtjes së tyre duke garantuar që proceset të kryhen në mënyrë të sigurt.

Për të garantuar të drejtat e të akuzuarve dhe po ashtu sigurinë e viktimave dhe dëshmitarëve, DHSK-ja mundëson procese të ndershme, të drejta dhe transparente si dhe siguron që drejtësia të vihet në vend duke përmbushur mandatin e vet.



*Banka ku ulen gjykatësit në sallën e gjyqit*



*Vendi për dëshmitarët në sallën e gjyqit*

**Kush mund të  
bëjë kërkesë për  
t'u pranuar si  
viktimë para  
DHSK-së?**



1. Një person



2. Që ka pësuar dëm fizik,  
material ose mendor



3. Si pasojë e drejtpërdrejtë  
e krimeve të paraqitura në  
aktakuzën publike

## Pjesëmarrja e viktimave

Korniza ligjore e DHSK-së parasheh pjesëmarrjen e viktimave në proceset gjyqësore. Viktimë quhet një person që beson se ka vuajtur personalisht dëm fizik, material apo mendor si **pasojë e drejtpërdrejtë** e krimeve për të cilat janë ngritur akuzat në një **aktakuzë** të konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Pas konfirmimit të një aktakuze, një viktimë mund të bëjë kërkesë për pjesëmarrje në proces. Paraqitësi i kërkesës për praninë si viktimë pjesëmarrëse në DHSK, duhet të paraqesë prova të dëmit që ka pësuar si pasojë e drejtpërdrejtë e cilitdo krim të paraqitur në aktakuzë. Vendimi merret nga paneli kompetent.

Personave që u miratohet statusi i viktimës pjesëmarrëse në procese, caktohen në një ose më shumë grupe, në përputhje me vendimin e trupit gjykues. Për përfaqësimin e një grupi viktimash, Administratori cakton një mbrojtës. Në marrjen e vendimit për caktimin e mbrojtësit merren parasysh mendimet, interesat dhe parapëlqimet e viktimave pjesëmarrëse. Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave administron sistemin e pagesave për mbrojtësit.

Mbrojtësit kanë detyrim t'i informojnë viktimat gjatë gjithë procesit gjyqësor dhe kërkojnë mendimet e dëgjojnë shqetësimet e tyre në lidhje me procesin gjyqësor me qëllim që këto mendime e shqetësime t'ua paraqesin gjykatësve. Gjatë përfaqësimit të një grupi viktimash, mbrojtësi i tyre mund: (i) të jetë i pranishëm në seanca gjyqësore dhe të bëjë parashtrime gojore ose me shkrim, si edhe t'u bëjë pyetje dëshmitarëve, sa herë që trupi gjykues e konsideron të nevojshme për interesat dhe të drejtat e viktimave; (ii) të ketë qasje në materialin e nevojshëm për përfaqësimin e grupit të viktimave të përcaktuar nga trupi gjykues; dhe (iv) t'i kërkojë trupit gjykues që të urdhërojë paraqitjen e provave dhe të dëshmimeve gojore të dëshmitarëve në lidhje me pasojat e krimeve mbi viktimat pjesëmarrëse në proces, në qoftë se aspekte të tilla nuk janë qartësuar siç duhet gjatë gjykimit.

Në fund të gjykimit, trupi gjykues mund të nxjerrë vendim mbi dëmet, humbjet dhe lëndimet e viktimave, i cili mund të jetë bazë për vendimin mbi zhdëmtimin.

# Avokati Popullit

---

Megjithëse Avokati i Popullit funksionon brenda Zyrës Administrative, ai është i pavarur në **monitorimin, mbrojtjen dhe ruajtjen** e të drejtave dhe lirive themelore të personave që ndërveprojnë me DHSK-në dhe ZPS-në.

Avokati i Popullit ka përgjegjësi **ekskluzive** për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Avokati i Popullit nuk mund të ndërhyjë në çështje gjyqësore ose proceset e tjera ligjore para DHSK-së, me përjashtim të rasteve kur ka vonesa të paarsyeshme. Avokati i Popullit mund të hyjë për inspektim në objektin e paraburgimit. Avokati i Popullit mund të marrë ankesa prej kujtudo që pretendon shkelje të të drejtave të veta prej DHSK-së dhe ZPS-së. Në lidhje me këtë Avokati i Popullit mund të hetojë lidhur me këto ankesa dhe, aty ku është e mundur, të propozojë ose mundësojë ndërmjetësim dhe pajtim për zgjidhjen e një ankese.

Gjithashtu Avokati i Popullit mund t'i bëjë referime Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese. Së fundi, Avokati i Popullit mund t'i paraqesë rekomandime Kryetarit të DHSK-së dhe Prokurorit të Specializuar për aspekte që janë pjesë e përgjegjësisë të tyre.



## Çështjet gjyqësore aktuale

---

Aktualisht, DHSK-ja ka para saj gjashtë çështje gjyqësore. Dy nga çështjet lidhen me krime lufte, njëra me krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, ndërsa çështjet tjera lidhen me vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Për informacion të përditësuar lidhur me proceset gjyqësore, mund të lexoni faqen zyrtare të internetit në <https://www.scp-ks.org/sq/cases>



# Fjalorth i shkurtër i termave juridikë

---

## **IDYSHUAR**

Person për të cilin Prokurori i Specializuar ka arsye të besojë se ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e një vepre penale në juridiksionin e DHSK-së.

## **IAKUZUAR**

Person i akuzuar për krimet e paraqitura në një aktakuzë të konfirmuar.

## **VIKTIMË**

Person që ka pësuar dëm si pasojë e drejtpërdrejtë e krimeve të paraqitura në një aktakuzë të konfirmuar.

## **DËSHMITAR**

Person që thirret nga cilado palë ose nga trupi gjykues për të dëshmuar në gjykim.

## **PALË**

Prokurori i Specializuar ose Mbrojtja.

## **MBROJTËS**

Avokat që përmbush kriteret për përfaqësimin e të dyshuarve, të akuzuarve ose viktimave. Avokati që përfaqëson një të dyshuar ose të akuzuar quhet mbrojtës i specializuar, kurse avokati që përfaqëson viktima, quhet mbrojtës i viktimave.

## **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**

Një krim që dihet se është kryer si pjesë e sulmeve të gjera dhe sistematike kundër popullatës civile.

## **KRIM LUFTE**

Shkelje e rëndë e Konventave të Gjenevës së vitit 1949 apo të drejtës zakonore ndërkombëtare, që është kryer gjatë një konflikti të armatosur kundër personave ose objekteve të mbrojtura.

## **VEPRA PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË**

Vepra penale që mund të pengojnë proceset gjyqësore para DHSK-së.

## **JURIDIKSION**

Autoriteti ligjor i DHSK-së për të shqyrtuar dhe marrë vendim lidhur me çështjet e paraqitura nga Prokurori i Specializuar.

## **LIGJ**

Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, i miratuar më 3 gusht 2015.

## **KONFERENCË PËR ECURINË E ÇËSHTJES GJYQËSORE**

Seancë në të cilën diskutohet ecuria e procesit me palët përkatëse.



← Bromovo 1  
← Wassewaar 2  
← Katwijk 15







DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E  
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

## **DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS**

### **Botuar dhe shpërndarë nga:**

Dhomat e Specializuara të Kosovës

### **Botuar në tri gjuhë:**

Anglishte, shqipe, serbishte

### **Për më shumë informacion, vizitoni faqen e Internetit të DHSK-së:**

[www.scp-ks.org](http://www.scp-ks.org)

### **Për pyetje nga mediat në lidhje me Dhomat e Specializuara të Kosovës:**

[mediaKSC@scp-ks.org](mailto:mediaKSC@scp-ks.org)

### **Për pyetje nga mediat në lidhje me Zyrën e Prokurorit të Specializuar:**

[spokespersonSPO@scp-ks.org](mailto:spokespersonSPO@scp-ks.org)

### **Paraqitja grafike:**

Wim Jansen Design

[www.wimjansendesign.nl](http://www.wimjansendesign.nl)


### **Shtypur nga:**

Quantes Grafimedia

[www.quant.es.nl](http://www.quant.es.nl)

**E drejta e autorit- © 2022 Dhomat e Specializuara  
dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës.**

**Të gjitha të drejtat të rezervuara.**





[www.scp-ks.org](http://www.scp-ks.org)